

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Paga minimale përballë çmimeve/ Ja ku renditet Shqipëria
ADRESA	https://www.cna.al/ekonomi/paga-minimale-perballe-cmimeve-ja-ku-renditet-shqiperia-i475304
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 06:10:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 05:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	931a4d4239c7eedf239ac4dbade9a8ab23153abfea6dd355a5b9323f85d7fcf3
TEKSTI	5b87a4fd8b09fb8d5e39cf2b9899eb224352b5e08faca17f96217c1c138600f2
PAMJA	a20cdb586f5dbcea6b5d5ae5bf1abf27f9473dbd69990bc3adf7c31c5f8b0e2a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	735b10ca6b3b9a83a51381349b0105f5f7d3301739b1ac6b3c27d3dba236d1e3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2da1c98ea07c52336cef3545e92b1a3ac1fae14de43d5323995db89b2f01bad6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/735b10ca6b3b9a83a51381349b0105f5f7d3301739b1ac6b3c27d3dba236d1e3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

08:04 Aktualitet

Këtë të diel në kryeqytet zhvillohet aktiviteti sportiv "T...

Paga minimale përballë çmimeve/ Ja ku renditet Shqipëria



27 Shtator 2026, 07:30, Ekonomi CNA



Çmimet e ushqimeve janë rritur ndjeshëm në Evropë gjatë pesë viteve të fundit, por në shumicën e vendeve rritja e pagave minimale ka qenë më e shpejtë. Shqipëria renditet ndër vendet ku fuqia blerëse e pagës minimale për ushqime është rritur me më shumë se 20%.

Sipas të dhënave të analizuara nga Euroneës Business, çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike në Bashkimin Evropian u rritën me 34% nga gushti 2021 deri në gusht 2026.

Rritjen më të madhe në BE e regjistroi Hungaria, me 57%, e ndjekur nga Bullgaria me 54% dhe Rumania me 53%. Në anën tjetër, Qiproja pati rritjen më të ulët, me 21%.

Në grupin më të gjerë prej 35 vendesh evropiane, Zvicra shënoi rritjen më të ulët të çmimeve të ushqimeve, me vetëm 5%.

Një rast krejt i veçantë është Turqia, ku çmimet e ushqimeve dhe pljeve joalkoolike u rritën me rreth 752% gjatë së njëjtës periudhë. Rritja lidhet me vite të inflacionit të lartë dhe zhvlerësimin e lirës, që ndikoi edhe në koston e mallrave dhe produkteve të importuara.

Pagat minimale janë rritur, por me ritme të ndryshme

Edhe pagat minimale bruto mujore janë rritur ndjeshëm në shumë vende evropiane.

Në Bashkimin Evropian, Hungaria regjistroi rritjen më të madhe, me 93%. Në Gjermani paga minimale u rrit me 46%, në Spanjë me 29%, ndërsa në Francë me 20%.

Turqia kryeson në grupin e vendeve të krahasuara për rritjen nominale të pagës minimale, me 823% gjatë pesë viteve. Rritje të forta u regjistruan edhe në Serbi, me 103%, dhe në Mal të Zi, me 102%.

Megjithatë, rritja e pagës nuk do të thotë automatikisht se një punëtor mund të blejë më shumë ushqime. Për të parë ndryshimin real, është më e rëndësishme të krahasohet fuqia blerëse e pagës me çmimet e ushqimeve.

Malta, Spanja dhe Franca humbin terren

Sipas krahasimit, në tre nga 26 vendet e analizuar fuqia blerëse e pagës minimale për ushqime është ulur gjatë pesë viteve.

Rënien më të madhe e pati Malta, me 6%. Kjo do të thotë se një punëtor me pagë minimale, që në gusht 2021 mund të blinte 100 shporta me ushqime, në gusht 2026 mund të blejë rreth 94.

Pas Maltës renditen Spanja, me një rënie prej 5%, dhe Franca, me 4%.

Në shumicën e vendeve të tjera, situata ka qenë e kundërt.

Serbia dhe Mali i Zi regjistruan rritjen më të madhe të sasisë së ushqimeve që mund të blihet me pagën minimale, me rreth 37%.

Rritje prej më shumë se 20% të fuqisë blerëse për ushqime u regjistruan edhe në Kroaci, Shqipëri, Ruman, Hungari, Bullgari dhe Lituan.

Në vende të tjera evropiane, rritja ishte më e moderuar: 10% në Irlandë, 9% në Gjermani, 7% në Greqi, 6% në Belgjikë dhe Holandë dhe 3% në Portugali.

Po Shqipëria?



Shqipëria bën pjesë në grupin e vendeve ku fuqia blerëse e pagës minimale ndaj ushqimeve është rritur me më shumë se 20% gjatë periudhës së analizuar.

Kjo do të thotë se, krahasuar me gushtin e vitit 2021, një person me pagë minimale në Shqipëri mund të blejë një sasi më të madhe ushqimesh në gusht 2026, pavarësisht rritjes së çmimeve.

Megjithatë, analiza mat vetëm raportin mes pagës minimale bruto dhe çmimeve të ushqimeve. Ajo nuk merr parasysh taksat, qiranë, faturat, transportin apo shpenzimet e tjera mujore të një familjeje.

Për këtë arsye, rritja e fuqisë blerëse ndaj ushqimeve nuk nënkupton domosdoshmërisht se të ardhurat reale të familjeve janë përmirësuar në të njëjtën masë.

Të dhënat tregojnë se gjatë pesë viteve të fundit çmimet e ushqimeve kanë ushtruar presion të konsiderueshëm mbi familjet evropiane, por në shumicën e vendeve të analizuar rritja e pagave minimale ka qenë e mjaftueshme për të ruajtur ose rritur sasinë e ushqimeve që mund të blejë një punëtor me pagën minimale./ CNA





Të sugjeruara

Monedhat e huaja në krizë/ Kursi i këmbimit, 27 shtator 2026

Monedhat e huaja nuk dalin nga gremina/ Kursi i këmbimit, 26 shtator 2026

Të dhënat për 6 mujorin e parë/ Ja cili shtet është investitori kryesor i huaj në Shqipëri

BE vë në dispozicion 922 milionë euro, por investimet me financim të huaj bien 20% në 8-mujor

WEF: Shqipëria me përmirësimin më të madh në botë në indeksin e turizmit, nga çmimet e lira

Rikthimi i penaliteteve, bizneset nuk po fitojnë, apo nuk po paguajnë/ Të ardhurat bien 5%

Monedhat e huaja në rënje/ Kursi i këmbimit, 25 shtator 2026

Në kulmin e krizës/ Qeveria propozon të shtohet taksë e re për naftën

Pasuritë e paluajtshme përbëjnë më shumë se 22% të aktiveve të sektorit të sigurimeve

Paratë në bankë kanë ende gjini/ Gratë vetëm 44% e depozituesve

BERZH: Ekonomia shqiptare pritet të rritet 3.5% nxitur nga reformat e BE-së, energjia mbetet rrezik

Bankat fshinë 5 miliardë lekë liri në qeverinë e parë të vitit

Ecja dhe shikimi, vështirësitë më të shpeshta të shqiptarëve/ 28% raportojnë kufizime

Mbrojtja nga shpenzimet në roaming, kontratat duhet të përcaktojnë një vlerë limit prej 6000 lekësh

Kursi i këmbimit, 24 shtator 2026

BSH: Rreziqe në tregun e brendshëm nga 3 faktorë, ja sektori më i ekspozuar

Rritja e çmimeve të banesave u frenua në gjysmën e parë të 2026

Kursimtare apo me më pak para?/ Familjet me kryefamiljare gra shpenzojnë 20 mijë lekë më pak

Blerjet e valutës dhe kredia, rritja e ofertës së parasë shënoi rekord të ri në korrik


Kostoja e shëndetit, 8% e shqiptarëve nuk përballojnë ekzaminimet, e dyta më e lartë në Europë

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

07:33 Opinione Sadik Bejko

Rasputin, patronazhizmi seksual

21:28 Opinione Erion Dasho

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.